



REPUBLIKA E SHQIPERISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME LEZHË SH.A

17.02.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15 % klor aktiv dhe Hipoklorit Kalciumi 60-70% klor aktiv për klorifikimin e ujit të pijshëm

REFERENCA: REF- 76355-02-17-2026

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 24311900-6 Klor, 24312220-2 Hipoklorit Natriumi.

VLERA E FONDIT LIMIT: 14 705 000 (katërmëdhjetë milion e shtatëqind e pesë mijë) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujesjelles Kanalizime Rajoni Lezhë Sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitet financiar dhe ekonomike, operatorët ekonomike duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit ku vlera ku vlera mesatare e xhiros në të paktën njërin prej tre viteve të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të këtij prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomike duhet të paraqesin dëshmitë si më poshtë;

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar në sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose / dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar në sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë nga QKL për prodhimin ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore me Kod II.8.B *“Sherbime ndërhyrëse Higjeno - shëndetësore”*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 40, pika 5/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikaten ISO 9001-2015 dhe / ose SSH EN ISO 9001:2015 standarti Shqiptar ekuivalent i normave europiane, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Çertifikata e mesiperme kerkohet nga autoriteti kontraktor UK Rajoni Lezhë Sh.a per te vertetuar se malli objekt prokurimi i ploteson kerkesat e cilesise nepermjet certifikatave te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organzima nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, kjo për shkak të rendesise së klorit dhe perdorimit te tij per konsum njerezor, pra per shkak se hipokloriti i natriumit dhe hipokloriti i kalciumit do te perdoret per klorifikimin e ujit te pijshem, ne te gjithe zonen e sherbimit te UK Rajoni Lezhe, duke përfshire Bashkine Lezhë, Bashkinë Kurbini dhe Bashkinë Mirditë, pra do jet i destinuar per perdorim human.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikaten ISO 14001-2015 dhe/ ose SSH EN ISO 14001-2015 standarti shqiptar ekuivalent i normave europiane për menaxhim mjedisi, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Çertifikata e mesiperme kerkohet nga autoriteti kontraktor UK Rajoni Lezhë Sh.a per te vertetuar se malli objekt prokurimi i ploteson kerkesat e cilesise nepermjet certifikatave te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organzima nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, kjo për shkak të rendesise së klorit dhe perdorimit te tij per konsum njerezor, pra per shkak se hipokloriti i natriumit dhe hipokloriti i kalciumit do te perdoret per

klorifikimin e ujit te pijshem, ne te gjithë zonen e sherbimit te UK Rajoni Lezhë Sh.a, pra do jet i destinuar per perdorim human.

2.3.5 Ofertuesi duhet të vertetojë se Hipokloriti i Natriumit që do të furnizohet është i përshtatshëm në trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor konform normave europiane SSH EN 901: 2007 "*Kimikate që përdoren për trajtimin e ujërave të destinuara për konsum njerëzor - Hipokloriti i natriumit*", dhe standarti shqiptar ekuivalent S SH EN 901:2007. Për këtë qëllim duhet të paraqitet si dokument kualifikues dokumentacion nga prodhuesi / ose nga Instituti i Shëndetit Publik për ato parametra të standartit që kryehen nga ana e tij si organ i autorizuar për kryerjen e testeve, si dhe paraqitjen e certifikatave të rezultateve të testeve zyrtare, të lëshuara nga laboratorë të akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë që nuk kryhen nga ISHP.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe në nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Çertifikata e mesiperme kërket nga autoriteti kontraktor UK Rajoni Lezhë Sh.a për të vërtetuar se malli objekt prokurimi i plotëson kërkesat e cilesisë nëpërmjet certifikatave të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kjo për shkak të rëndësisë së klorit dhe përdorimit të tij për konsum njerëzor, pra për shkak se hipokloriti i natriumit dhe hipokloriti i kalciumit do të përdoret për klorifikimin e ujit të pijshëm, në të gjithë zonen e shërbimit të UK Rajoni Lezhë Sh.a pra do jetë i destinuar për përdorim human.

2.3.6 Ofertuesi duhet të paraqesë fletë analizë nga prodhuesi ku vërtetohen parametrat siç kërkohen si dhe fletë analizë toksikologjike ose dëshmi të testeve nga ISHP (Instituti i Shëndetit Publik) dhe nga autoritete/ institucione/ ente të autorizuar për lëshimin e tyre, të cilat paraqesin rezultatet mbi parametrat e hipokloritit të natriumit dhe hipokloritit të kalciumit konform normave europiane.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe në nenin 40, pika 6, shkronja c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Ky kriter është vendosur me argumentin se ofertuesi duhet të vërtetojë se hipokloriti i natriumit dhe i kalciumit që do të furnizohet është i përshtatshëm konform rregullave dhe standarteve për trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor, konform normave europiane S SH/EN 901:2013 si dhe standarteve kombëtare nga ISHP (fletë – analizë). Për këtë qëllim duhet të paraqitet si dokument kualifikues dokumentacion nga prodhuesi që dëshmon që produkti i prodhuar plotëson standartin europian të kërkuar S SH/EN 901:2013. Dhe në zbatim të ligjit nr. 10 138, datë 11.5.2009, "Për shëndetin Publik".

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues në tender që është prodhues vendas duhet të paraqesë leje mjedisore të kategorisë "A" për impiante të industrisë kimike, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e Ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 40, pika 7, shkronja c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Gjithashtu ky kriter është vendosur duke u mbështetur në Ligjin Nr. 10448, Datë 14.07.2011 “Për Lejet Mjedisore”, i ndryshuar.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumenta për pronësinë apo qiramarrjen për mjet transporti me kapacitet mbartes jo më pak se 3 ton, për transportin e lendeve kimike me rrezikshmeri të lartë, ndaj vendeve të përcaktuara nga Shoqëria Rajonale Ujësjetles Kanalizime lezhë Sh.a, për të gjithë kohën e ekzekutimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë mjet duhet të shoqërohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) Kur janë në pronësi duhet të dokumenti që verteton regjistrim mjet (leje qarkullimi), certifikate pronësie, certifikate për transportin e mallrave të rrezikshëm dhe siguracionin e mjetit.
- b) Nëse mjeti është i marrë me qira kontratë e qerash duhet të mbulojë të gjithë periudhën e ekzekutimit të kontratës shoqëruar me çertifikatë pronësie, leje qarkullimi, siguracionin e mjetit certifikate për transportin e mallrave të rrezikshëm.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me Ligjin Nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve” si dhe me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”.

Ky është një kriter jo vetëm i nevojshëm por i domosdoshëm, pasi klori i lëngshëm duhet të sillët nga operatori ekonomik sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor direkt në tankerat e klorit në stacionet e pompimit të ujit të pijshëm të cilat funksionojnë me injeksion, kanë kapacitet mbajtës 20 ton dhe në bazë të konsumit mujorë përcaktuar në grafikun e levrimit i cili është 14 166 kg në muaj operatori ekonomik fitues për një mjet transporti për transportin e lendeve kimike me rrezikshmeri të lartë jo më pak se 3 ton, frekuenca e furnizimit nga operatori ekonomik do të jetë 5 herë në muaj. Kjo sasi hipoklorit natriumi mujor me mjet transporti jo më pak se 3 ton do të duhet të garantojë Autoritetin Kontraktorë për disponueshmërinë e mallit objekt prokurimi i cili është garant për furnizimin mujor me hipoklorit natriumi, sipas grafikut të levrimit, frekuencës mujore të furnizimit dhe sipas nevojave për cilësinë e ujit të pijshëm e për rrjedhojë garantimin e shëndetit dhe jetesës së konsumatorëve. Prandaj është e domosdoshme dhe e qartë që operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë mjet transporti sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor për këtë qëllim, në pronësi ose ta sigurojë atë nëpërmjet kontratës së qirasë për ta kryer shërbimin në kohë, sasi dhe cilësi sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetles Kanalizime Lezhë Sh.a për klorifikimin e ujit të pijshëm gjatë gjithë periudhës së ezaurimit të kontratës prej 170 000 kg hipoklorit natriumi.

Shenim: Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku OE vet-deklaron mjetin (që disponon për realizimin e kontratës) me targën respektive. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE reeditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Ligjin Nr. 27/2016 “ Për menaxhimin e kimikateve” si dhe me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 488, datë 29.6.2016 “ Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. Specifikimet teknike

Specifikimi i materialeve:

Hipokloriti i Natriumit (NaOCl) duhet të jetë në përputhje me standardin SSH EN 901:2007 ose ekuivalent, për kimikatet që përdoren në trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor, dhe përdorimi i tij duhet të garantojë që uji i trajtuar të përmbushë kërkesat e VKM nr. 379, datë 25.05.2016, ‘Për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor’, i ndryshuar.”

Nr.	Parametrat	Njësia e matjes	Specifikat kimike
1	Gjendja	-	Lëng i kthjellët
2	Ngjyra	-	E verdhë e çelët
3	Densiteti në 20 ⁰ C	gr/ml	1.13 1.28
4	Titulli i Cl ₂	%	13.5 -14.5
5	Substanca toksike	mg/kg	Limitet në mg/kg të klorit të lirë
6	Arsenik (As)	mg/kg	max 1
7	Kadmium	mg/kg	max 2.5
8	Krom (Cr)	mg/kg	max 2.5
9	Merkur	mg/kg	max 2.5
10	Nikel (Ni)	mg/kg	max 2.5
11	Plumb (Pb)	mg/kg	Max 15

12	Antimon (Sb)	mg/kg	max 20
13	Selen (Se)	mg/kg	max 20

Hipokloriti i Kalciumit duhet të jetë në përputhje me standardin **SSH EN 900:2014 ose ekuivalent**, për kimikatet që përdoren në trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor. Përdorimi i produktit duhet të garantojë përmbushjen e kërkesave të VKM nr. 379/2016, i ndryshuar.

Paketimi me ambalazhim plastik me peshë 30-50 kg, rezistent ndaj lageshtires.

Ruajtja: në ambiente të thata dhe të ajrosura, larg lagështirës.

Jetëgjatësia: jo më pak se 12 muaj nga data e prodhimit.

Hipoklorit Kalciumi (në mg/kg të klorit aktiv 60-70%)

Nr.	Parametrat	Njësia e matjes	Specifikat kimike
1	Gjëndja	-	Granuluar
2	Ngjyra	-	E verdhë e hapur
3	Titulli Cl ₂	% m/m	60 -70
4	Kadmium (Cd)	mg/kg	Max 5
4	Krom (Cr)	mg/kg	Max 20
6	Plumb (Pb)	mg/kg	Max 15

Përshkrim i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Specifikimet janë hartuar në përputhje me Standartet Shtetërore Shqiptare përkatëse konkretisht Hipokloriti i Natriumit dhe Kalciumi, standartin S SH EN 901:2007 për hipoklorit natriumi.
2. Specifikat e automjetit që do të shërbejë për furnizimin e kimikateve:

Furnizimi me kimikate do të kryhet me automjet të çertifikuara për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE. Automjeti për transportin e kimikateve duhet të jetë i përshtatshëm për të mbajtur prodhim të destinuar për trajtimin e ujit të pijshëm.

Sasia e mallit që kërkohet:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

1	Hipokloorit Natriumi (NaOCL) 13-15%	165 000 kg	Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë Sh.a	12 muaj Çdo muaj nga 13 750 kg
2	Hipoklorit Kalciumi 60-70%	23 000 kg	Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë Sh.a	12 muaj (të ndara në dy parti malli) 11 500 kg brenda 30 diteve nga nënshkrimi i kontrates Ndërsa 11 500 kg pas 6 muajsh nga nënshkrimi i kontrates

Çertifikata e origjinës dhe raport analiza duhet të shoqërojë produktin për sasi të kërkuar sipas lëvrimit periodik.

Afatet e lëvrimit : 12 muaj nga nënshkrimi i kontrates.

Mënyra e levrimit: Furnizimi me Hipoklorit Natriumi 13- 15% klor aktiv do te behet çdo muaj nga 13 750 kg sipas dispozitave ligjore ne fuqi per furnizimin me hipoklorit natriumi, ne depozitat e stacionit te pompave te ujit te pijshem Barbulloje, ne depozitat e stacionit te pompave te ujit te pijshem Ishull Lezhe, Bashkia Lezhe dhe depozitat e ujit te pijshem Rreshen, Bashkia Mirdite, ne depozitat e ujit te pijshem Laç, shoqeruar me dokumentacionin dhe faturen perkatese per cdo parti malli.

Mënyra e levrimit: Furnizimi me Hipoklorit Kalciumi 60-70 % klor aktiv do bëhet me dy parti malli, partia e pare e mallit prej 11 500 kg do të dorëzohet në UK Rajoni Lezhë Sh.a jo më vonë se një muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, me ambalazhim plastik (preferuar 30 - 50 kg) , rezistent ndaj lageshtires ndërsa pjesa e mbetur Hipokloritit të Kalciumit 60-70 % klor aktiv e mbetur prej 11 500 kg do dorëzohet pas 6 muajsh nga nënshkrimi i kontrates.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me VENDIM Nr. 379, datë 25.5.2016 “Për Miratimin e Rregullores “Cilësia e Ujit të Pijshëm”, në Ligjin nr. 10 138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin Publik” në Ligjin Nr. 9108, datë 17.07.2003 ” Për substancat dhe preparatet kimike”, në Ligjin Nr. 27/2016 “ Për menaxhimin e kimikateve” si dhe me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 488, datë 29.6.2016 “ Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, në Ligjin Nr. 10448, Datë 14.07.2011 “ Për Lejet Mjedisore”, i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT